

7 Periudha (fjalë e përbërë)

Periudha dhe mjetet gjuhësore të ndërtimit të saj

Periudha formohet prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore dhe përbën një unitet kumtesor, gramatikor dhe intonacionor.

Mjetet gjuhësore të ndërtimit të periudhës janë: intonacioni; mjetet e lidhjes (lidhëzat, përemrat lidhorë, ndajfoljet lidhore, fjalët korrelative); veçoritë e ndërtimit sintaksor të njësisive kallëzuesore të periudhës; bashkëlidhja e trajtave kohore dhe mënyrore të foljeve-kallëzues; rendi i fjalëve të periudhës.

1. **Intonacioni** është element i përhershëm dhe shumë i rëndësishëm.
2. **Mjetet e lidhjes:** Lidhëzat, përemrat lidhorë, ndajfoljet lidhore dhe fjalët korrelative

-Lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse janë elemente të domosdoshme në fjalitë e përbëra lidhëzore. Ato ndahen në dy grupe:

Lidhëza semantike, që kanë një kuptim (*e, dhe* që shprehin idenë e bashkimit; *por* - të kundërvënies; *sepse* - të shkakut etj.)

Lidhëza sintaksore, pa kuptim të përcaktuar (ato fillose *se, që*).

-Përemrat lidhorë dhe ndajfoljet lidhore mund të shërbejnë si mjete që lidhin fjalitë e periudhës, ndaj quhen fjalë lidhëse, si: *që, i cili, e cila* etj., *ku, kur, tek, nga*.

-Fjalët korrelative përdoren brenda fjalisë kryesore dhe paralajmërojnë se brendia e tyre konkrete do të sqarohet në pjesën e varur. Ato janë korrelate të lidhëzave a fjalëve lidhëse. Si fjalë korrelative shërbejnë: ndajfoljet *aq, kaq, ashtu, kështu, atëherë* etj. përemrat dëftorë: *ai, ky, i tillë*; ndonjë përemër i pacaktuar: gjithë, kushdo, cilido.

3. Veçoritë e ndërtimit sintaksor të fjalëve në periudhë

Fjalitë e periudhës, duke qenë vetëm brenda një tërësie, i përshtaten në disa raste njëra tjetrës nga ana sintaksore. Kjo përshtatje shprehet: në mungesën e një gjymtyrë të domosdoshme të njëra pjesë, si dhe në paralelizmin sintaksor. Kështu në disa tipa fjalësh të përbëra mungon një gjymtyrë e domosdoshme në pjesën kryesore (p.sh.: kryefjalë, kundrinor etj.) dhe pjesa e nënrenditur kryen pikërisht funksionin e kësaj gjymtyrë (të kryefjalës, të kallëzuesit emëror, të kundrinorit), p.sh.:

Trajnerit i ra menjëherë në sy *se skuadra ishte mjaft optimiste*. Kësaj radhe ishte Agroni *që u përgjigj i pari*. Studiuesit mendojnë *se për lashtësinë e gjuhës shqipe ka fakte të shumta*.

Paralelizëm sintaksor hasim kur dy pjesë të një fjalie të përbërë kanë gjymtyrë të njëjta (si lloj), rend të njëjtë të tyre dhe intonacion të njëjtë. Lidhja e tyre bëhet me lidhëzat *por, kurse, ndërsa*: Sokoli merrej me basketboll, *kurse* stërvitej për atletikë.

4. Bashkëlidhja e trajtave kohore të foljeve-kallëzues

Në fjalitë e bashkërenditura bashkëlidhja e trajtave kohore tregon njëkohësi veprimesh (në të tashmen, në të shkaurën, në të ardhmen), p.sh.: *e tashme + e tashme*: Dielli shkëlqen dhe vesa avullon menjëherë; *e pakryer + e pakryer*: Shiu i rridhte nëpër flokë dhe udhëtari merrte frymë me zor; më se e kryer + e pakryer: Era kishte pushuar dhe peshkatarët po mblidhnin rrjetat.

5. Rendi i fjalëve të periudhës

Rendi i pjesëve ka rëndësi të madhe si për strukturën, edhe për vlerën e fjalisë. Në disa tipa fjalësh rendi i pjesëve është i ngulitur, në të tjera është i lirë. P.sh. në fjalitë bashkërenditëse kemi rend të ngulitur: *Ishte natë dhe frynte një veri i hollë. Kamioni u ndal dhe prej tij zbriti Afërdita. Hapi derën dhe doli jashtë me nxitim*.

Në fjalitë e përbëra me nënrenditje rendi mund të jetë i ngulitur ose i lirë. Në fjalitë me pjesë të nënrenditur përcaktore, rendi i ngulitur: pjesa e nënrenditur qëndron pas kryesores. Kur është i lirë, pjesa e nënrenditur mund të qëndrojë pas, para ose në mes të kryesores.

Disa nga skemat strukturore të periudhës

1. Periudhë me bashkërenditje: *Ishte i ri në punë,/ por ishte i palodhur. Mëngjeseve ose shkruante, / ose përkthente materiale të reja, / ose përpunonte ato të ditës së kaluar.*
2. Periudhë asindetike: *Zure gjarpurin,/ shtypi kokën. Gjyshi tregonte,/ ne dëgjonim,/ më të vjetrit miratonin me kokë.*
3. Periudhë me ndërthurje të bashkërenditjes me asindetizmin: *Kastrioti u ul në gjunj, / mori një grusht me dhe / dhe e puthi i përmalluar.*
4. Periudhë me nënrenditje: *Kur mori lajmin,/ Skënderbeu u nis si rrufe,/sepse koha nuk priste. (paralele)*

Periudha me bashkërenditje

Fjalja e përbërë me bashkërenditje quhet ajo që përbëhet nga dy a më shumë pjesë homogjene të bashkuara me anën e lidhëzave bashkërenditëse.

Në bazë të marrëdhënieve dallohen pesë tipa:

1. fjalia me bashkërenditje këpujore;
2. kundërshtore;
3. veçuese;
4. përmbyllëse;
5. shkakore-motivuese.

Periudha me bashkërenditje këpujore

Këto fjali paraqesin larmi të madhe si nga struktura, ashtu dhe nga nuancat kuptimore. Për bashkimin e pjesëve përdoren lidhëzat këpujore *dhe, e, edhe, as, as...as.*

P.sh.: Frynte erë e fortë *dhe* xhamat dridheshin. (**shkak-pasojë**) Ajo shtëpi ishte mësuar me mysafirë dhe prandaj vizita jonë u duk fare e natyrshme. (**shkak-pasojë**)

Nata atje është tjetër natë *edhe* dita tjetër ditë. (marrëdhënie përqsore); Peshku në det *e* tigani në zjarr. (**marrëdhënie mospajtimi**);

Kalorësi jo vetëm që u ndal, *por* i zbriti edhe kalit. (marrëdhënie shkallëzimi)

Periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie kundërshtore

Për këto është karakteristike struktura dygjymtyrëshe. Ndërtohen me lidhëzat kundërshtore: *po, por, mirëpo, porse, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, me pjesëzat-lidhëza vetëm, veç, me lidhëzat veçse, vetëm se.*

E bija ishte e urtë, *kurse* djali ishte i rrëmbyer. (përqsasje)

Në mëngjes bënte freskët, *por* nga dreka ngruhej. (marrëdhënie kontrasti)

Supa që e mirë, *po* duhej ngrohur pak. (kundërshtore-kufizuese)

Ai ishte shëndetlig, *por* megjithatë punën s'e la asnjë ditë. (kundërshtore-lejore)

Të kam mik, *pa ndryshe* s'ta hapja zemrën. (marrëdhënie me nuanca kushtoreje)

Çdo gjë ujdiset, veç mjekër e qoses nuk ujdiset (me ngjyime përjashtuese)

Periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie veçuese

Këto fjali japin dy a më shumë fakte, dukuri etj., që përjashtojnë njëri-tjetrin; realizimi i njërit përjashton realizimin e tjetrit. Ndërtohen me lidhëzat veçuese të thjeshta *o, a, ose, ja, apo ose* të përsëritura *o.o, a.a, ose.ose* etj.

Ja të vdesim, *ja* të rrojmë për liri. (marrëdhënie veçimi e përjashtimit tërësor);

Natën *herë* binte shi, *herë* binte borë. (marrëdhënie veçimi e përjashtimit alternativ).

Periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie përmbyllëse

Struktura e fjalisë është patjetër dygjymtyrëshe. Ndërtohen me lidhëzat andaj, ndaj, pra, pa, psh: Do të kalojmë në zona të ftohta, *ndaj* vishuni mirë.Se të dua të mirën, *pa* t'i them këto fjalë, mor bir.

Periudha me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie shkakore-motivuese

Me lidhëzën *pa* mund të shprehen marrëdhënie *shkakore-motivuese*. Pjesa e dytë motivon kërkesën e parashtruar në pjesën e parë. Pjesa e parë e ka foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore. Kurse e dyta në të tashmen dëftore: Shko ti, *pa* ta mbaj unë djalin. Ik, në ke punë, *pa* ta bluaj unë.